**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

**Nr.__3__ prot.** **Kamëz, më 24. 1 . 2025**

# V E N D I M
**Nr.__3__.Datë 24.1 2025**
**MBI**
**"DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE BANESE"**

**Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.01.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.01 Datë 20.01.2025,** në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",; Ligji, Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30, pika gj; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore",; VKM nr.597 dt. 04/09/2019 kreu 4 pika 3 për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmen Ekonomike; Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë nr.1158, datë 20.12.2024, dhe nr.08, datë 07.01.2025 për evidentimin, konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesë, relacionit të hartuar nga ekspertët e administratës së Bashkisë në zbatim të urdhërave, dhe V.K.B. Kamëz Nr. 119, datë 19.12.2024 "Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2025 dhe planit të buxhetit për vitet 2025 , 2026, dhe 2027, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606; **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

## V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për djegie banese të:
   z. për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 14.12.2024.
   znj. për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 25.12.2024.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjorë hartuar në formën e kritereve në relacion, sipas preventivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve hartuar nga ekspertët e administratës së Bashkisë Kamëz, në zbatim të Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë "Për ngritjen e komisionit të konstatimit dhe vlerësimit të dëmtimeve të shkaktuar në banesën e z. Sabri Kërçyku, dhe Kimete Domi".
3. Të akordohet një ndihmë financiare për këto familje sipas tabelës më poshtë:

| **Nr** | **Emër Atësi Mbiemër** | **Vlera e dëmit lekë** | **Për pagesë, 50% e vlerës në lekë, sipas VKM-së nr. 329, dt. 16.05.2012** |
|---|---|---|---|
| 1 | | 939,123 | 469,561 |
| **2** | | 342,647 | 171,323 |
| | **T O T A L I** | **1,281,770** | **640,884** |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Ndihma financiare për familjet e dëmtuara përcaktohet sipas kritereve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*" *dhe VKM nr.597 dt. 04/09/2019 kreu 4 pika 3 për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.*
5. Kjo shumë prej **640,884 ( gjashtëqind e dyzet mijë e tetëqind e tetëdhjete e katër )** lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI**
**HYSEN KOLDASHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ